

HAPET THIRRJA PËR BURSA PËR STAFIN AKADEMIK PËR MËSIMDHËNIE NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS + NË UNIVERSITETIN E LUND, NË SUEDI

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Lund-it, në Suedi.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (14 ditë);

Fushat e studimit:

-Informatikë dhe Teknologjitë e Komunikimit;

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin ditor për stafin (160 Euro në ditë);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Procedura e aplikimit dhe dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi;
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli minimal i rekomanduar B2);
- **Plani i mobilitetit për mësimdhënie;

***Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi i propozuar nga ana juaj që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe Koordinatori Institucional Erasmus + në Universitetin e Tiranës, i cili është Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikim: 23 Dhjetor 2016

Periudha e mobilitetit: mobiliteti duhet të kryhet para muajit Korrik 2018. Fituesi i bursës pas përzgjedhjes do të kontaktojë me universitetin pritës për të përcaktuar periudhën e mobilitetit.

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë si edhe të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!